



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 179, datë 13.12.2011

PËR

LICENCIMIN E “RAIFFEISEN INVEST SHOQËRI ADMINSTRUESE E FONDEVE TË PENSIONIT DHE SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE” SH.A

Në bazë dhe për zbatim të pikës 6/j, pikës 23 të nenit 14, Ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, nenit 20, pika 2 dhe nenit 26, të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, nenit 13, pika 3 dhe nenit 16, të Ligjit nr. 10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E :

“Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen” sh.a, e cila mban licencën nr. 1, datë 18.10.2010 për të vepruar si shoqëri e administrimit të fondeve të pensionit vullnetar, për mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensioneve, si dhe kryerjen e pagesave të pensionit, ka paraqitur kërkesën për shtrirjen e veprimtarisë edhe në administrimin e aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Shtrirja e veprimtarisë reflektohet në ndryshimet e Statutin të Shoqërisë “Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company” sh.a, si dhe ndryshimin e emrit, nga “Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen” sh.a në “Raiffeisen INVEST - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive” sh.a.

Në bazë të nenit 20, pika 2, të Ligjit nr. 10197, Autoriteti mund të lejojë që shoqëria

administruese e fondeve të pensionit, të kryejë veprimtari administrimi të fondeve të investimeve, me kusht që shoqëria administruese të jetë e pajisur me licencën e duhur, për të kryer këtë veprimtari.

Për sa më sipër Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

- 1.** Licencimin e Shoqërisë “Raiffeisen INVEST Shoqëri Adminstruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive”, për të kryer veprimtari administrimi të asetëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive krahas veprimtarisë si shoqëri e administrimit të fondeve të pensionit vullnetar.
- 2.** Miratimin e ndryshimeve të statutit të shoqërisë “Administruese të Fondeve të Pensionit Raiffeisen” sh.a, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
- 3.** Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI

Ndryshimet në Statutin e Shoqërisë “Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company” sh.a, si më poshtë:

1. Në bazën ligjore të statutit shtohet referenca:

“Ligjin nr. 10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”

2. Paragrafi 2.1, i nenit 2, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Emri ligjor i shoqërisë do të jetë: *“Raiffeisen INVEST - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive”*

3. Neni 3, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Objekti i aktivitetit të shoqërisë është:

- a) administrimi i fondeve të pensionit vullnetar nëpërmjet mbledhjes dhe investimit të fondeve të pensionit, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, si dhe në përputhje me parimin e diversifikimit të riskut, me qëllim ofrimin e përfitimeve të pensionit për personat që anëtarësohen në fondin e pensionit. Shoqëria mund të ushtrojë edhe funksionin e kryerjes së pagesave të pensionit;
- b) Krijimi dhe/ose administrimi i sipërmarrjeve të investimeve kolektive bazuar në Ligjin nr. 10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”;
- c) Të tjera aktivitete siç parashikohet në Ligjin nr. 10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”;

4. Neni 19, ndryshohet si më poshtë vijon:

“19.1. “Këshilli i Administrimit emëron 2 (dy) persona fizike si administratorë për një afat jo më gjatë se 3 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje. Administratorët do të jenë njëkohësisht anëtarë të Këshillit të Administrimit;

19.2. Këshilli i Administrimit do të emërojë një Administrator të Përgjithshëm dhe një Zëvendës Administrator të Përgjithshëm nga administratorët;

19.3. Shoqëria do të përfaqësohet ligjërisht nga Administratori i Përgjithshëm, dhe në mungesë të tij, nga Zëvendës Administratori i Përgjithshëm. Për transaksionet financiare në lidhje me veprimtarinë e fondeve të pensionit dhe SIK, shoqëria do të përfaqësohet bashkërisht nga dy Administratorët ose nga një Administrator dhe një nëpunës i autorizuar për të nënshkruar në emër dhe për

llogari të shoqërisë. Rregullat e detajuara në lidhje me të drejtën e nënshkrimit në Shoqëri do të përcaktohen nga Këshilli i Administrimit;

19.4. Administratori i Përgjithshëm do të veprojë si Drejtues i Zyrës Kryesore (Front Office), ndërsa Zëvendës Administratori i Përgjithshëm si Drejtues i Zyrës së Prapavijës (Back Office);

19.5. Këshilli i Administrimit mund të shkarkojë Administratorët në çdo kohë nga detyra;”

5. Fjalja e dytë në paragrafin 12.3, të nenit 12, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Nuk konsiderohet interes financiar pjesëmarrja si investitor në fondet e pensionit ose në SIK”

6. Paragrafi 20.4, i nenit 20, ndryshohet si më poshtë vijon:

“20.4. “Administratorët duhet të zbatojnë të gjitha detyrat e përcaktuara në Ligjin nr 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar” si dhe në Ligjin nr. 10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”;”

7. Paragrafi 1, i nenit 21, fjalët “fondi i pensionit dhe anëtarët e tij” zëvendësohen nga fjala “investitorët”;

8. Paragrafi 25.5, i nenit 25, ndryshohet si më poshtë vijon:

“ 25.5. “Në rast falimentimi të shoqërisë administruese, asetet e fondit të pensionit dhe të SIK që zotërohen nga investitorët, do të trajtohen siç do pasuri tjetër, që i nënshtrohet të drejtës së veçimit, sipas legjislacionit shqiptar për falimentimin”. ”

